



SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA PENALE NDËRKOMBËTARE”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Penale Ndërkombëtare
Programi:	Juridik i Përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	14:00 - 16:15
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari
Të dhënat kontaktuese:	halim.bajraktari@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda: E Drejta Penale Ndërkombëtare do t’u ofrojë studentëve njohuritë bazike nga kjo fushë e studimit, duke filluar nga: përkufizimi dhe lënda e studimit; burimet e së drejtës penale ndërkombëtare; kontributin e OKB-së, BE-së dhe Këshillit të Evropës në këtë lëmi; parimet themelore. Duke trajtuar tema si: ekstradimi; ndihma juridike-penale ndërkombëtare; bashkëpunimi policor ndërkombëtar; njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, si nga legjislacioni ndërkombëtar, ashtu edhe nga legjislacioni nacional.</p> <p>Kjo lëndë do tu ofrojë njohuri studentëve edhe në trajtimin e tribunaleve ndërkombëtare; Gjykatës Penale Ndërkombëtare; Dhomat e Specializuara dhe zyra e Prokurorit të Specializuar. Nëpërmjet trajtimit të rasteve praktike gjyqësore, do t’u mundësohet studentëve në zhvillimin e mendimit kritik po ashtu edhe në zgjidhjen e problemeve praktike nga kjo lëmi.</p>
Qëllimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ofron njohuritë e përgjithshme në intensifikimin dhe zgjidhjen e problemeve me natyrë penale ndërkombëtare, për të kuptuar mirë konceptet dhe anën praktike të kësaj lënde penale me element ndërkombëtar.</p> <p>Në rrethana kur sot bota ballafaqohet nga trendi gjithnjë e më rritje të kriminalitetit të veprave penale dhe problemeve me natyrë penale ndërkombëtare, nevoja për studimin e kësaj lëmie sa vjen e shtohet në shumë</p>

	<p>dimensione ndërkombëtare për të parandaluar bashkëpunimin kundër dukurive gjithnjë e në rritje të veprave penale si: krimet e gjenocidit, krimet kundër njërezimit, krimet e luftës, krimet kundër paqes, terrorizmi, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me armë, kontrabanda me narkotikë, pastrimi i parasë, korrupsioni, delikuenca e të miturve, shkelja flagrante e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vrasjet nga motive të ndryshme, krimi ekonomike- financiare, në trafikun publik dhe forma tjera të krimit, të cilat po e përcjellin shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, mund t'i kundërvihemi me sukses, jo vetëm me mekanizmin e preventivës dhe represionit, por edhe me thellimin e studimeve rreth njohjes së shkaqeve dhe rrethanave që kushtëzojnë këto fenomen negativ në relacione kombëtare- rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Prezente do jenë edhe tematikat me aktualitet të fushës ndërkombëtare penale bashkëpunimet dhe lidhja e marrëveshieve të ndryshme që sot bota ballafaqohet me këto ndimesa të kohës ku dhe ne do jemi pjesë e këtyre proceseve bashëpunuese në nivel regional, europian e atë ndërkombëtare duke qënë pjese e këtyre agjencive-mekanismave si në spektin përfitues dhe në atë kontribues e bashkëpunues.</p> <p>Kjo degë e së drejtës është planifikuar të ndihmojë studentët që të kenë njohuritë e duhura për këtë lëndë, si një mundësi përfituese e bashkëpunuese me juridiksionin e shteteve të ndryshme, dhe Kosovës dhe me gjërë. Të njoftohen me faktin se e drejta penale në përgjithësi dhe e drejta penale ndërkombëtare në veçanti, kanë për objekt studimi veprën penale, përgjegjësinë penale, sanksionet penale dhe institutet tjera që janë të përcaktuara në kodet penale aktuale interne, Konventat Ndërkombëtare në statutet e Tribunaleve ndërkombëtare ndërkombëtare dhe në aktet tjera ligjore vendore e ndërkombëtare, e të cilat do të mësohen dhe studiohen në kuadër të kësaj lënde mësimore, me qëllim që këto institute të</p>
--	--

	<p>bëhen më të qarta, më të kuptueshme dhe praktikisht më lehtë të zbatueshme.</p> <p>Një rëndësi i kushtohet edhe lëndës si një nevojë praktike e kohës dhe aktualiteteve që vendi ynë po akohet me problemet e kriminalitetit, ekstradimit dhe pashkpunimeve të ndryshme e sidomos formimit të Gjykatës Speciale për Kosovën, duke studiuar veprat penale, sanksionet penale përmese akteve e kodeve dhe rregullave ndërkombëtare duke ndërtuar e mundësuar që të ketë më shumë paqe e siguri për njerëzimin sot dhe në të ardhmen.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit:</p>	<p>Studentët pritet të kenë fituar njohuri solide mbi nocionet dhe lëndën e kësaj disipline, normat në DPN, mbi pushtetin represiv dhe juridiksionin e shteteve, mbi ekstradimin, azilin, transferimin e procedurës penale, bashkëpunimin dhe ndihmën penale juridike, si dhe korpusin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe juridiksionin e instancave penale ndërkombëtare.</p> <p>Të kuptojnë parimet themelore të DPN pozitën dhe rolin e kësaj lënde tani dhe në të ardhmen në vendin tone dhe në gjërë, mbi interesat e kësaj lënde;</p> <p>-Të kritikojnë dhe debatojnë, të mbrojnë e vertetojnë çështjet aktuale të lëndës të argumetojnë qëndrimin e tyre duke u bazuar në parimet dhe rregullat juridike kombëtare dhe atyre ndërkombëtare mbi të drejtën penale ndërkombëtare.</p> <p>-Ofrimi i shembujve praktik do të ketë për qëllim arritjen e shkallës së aftësisimit të studentëve për interpretimin e ligjit dhe krijimin e opinionit ligjor.</p> <p>-Aspektet komparative nga të drejtat e vendeve të tjera do të ofrohen vetëm në rastet e nevojshme për të plotësuar zbrazëtitë teorike të së drejtës në Kosovë dhe për të avancuar njohuritë juridike.</p> <p>-Në këtë kuptim, studentët do të aftësohen që të jenë në gjendje për të krijuar opinionin juridik lidhur me</p>

	<p>çështjet penale ndërkombëtare, për të arritur te një konkluzion, i cili ka bazën ligjore dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.</p> <p>-Theks të veçantë do t'i kushtohet aftësimin për analizë juridike në bazë të argumenteve.</p> <p>-Të rrisë aftësitë e studentit në aspektin personal dhe profesional– si një metodë zbatuese e përfituese në këtë trend europian e ndërkombëtar.</p>		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	2	6	6
Kollokfiume, seminare	2	6	6
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	10	10
Projektet, prezantimet ,etj	1	10	10
Totali			150 Orë (6 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive te studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtën penale ndërkombëtare. Do të inkurajohen studentët që të marrin pjesë aktive në ligjërata dhe në ushtrime përmes prezantimeve të ndonjë eseje ose punimi seminarik nga fusha e kësaj të drejte. Ligjërata do të prezantohet sipas metodës</p>		

	<p>interaktive (sokratike). Gjatë ligjëratave të lëndës po ashtu, do të përdoren metodat bashkëkohëse të mësimdhënies, me efekt që kjo si degë e së drejtës të bëhet më e kapshme, më e qartë dhe më e lehtë për t'u mësuar dhe zbatuar</p>
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Kollokfiimi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).</p> <p>-Provimi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).</p> <p>-Çdo student duhet t'i nënshtrohet provimit!</p> <p>-Nëse nota e kollokfiimit të sukseshëm është më e lartë se ajo e provimit të sukseshumë, atëher do të nxirret nota mesatare si notë përfundimtare.</p> <p>Në të gjitha rastet tjera vlenë vetëm nota e provimit.</p> <p>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim prezentime te punimeve do të vlersohet me 10% të pikëve të mundëshme (100)</p>
Literatura	
Literatura primare:	<p>- <i>Ismt Salihu, E drejta penale ndërkombëtare, Me komentarin e shkurtër të Ligjit për Gjykatën Speciale. UBT, Prishtinë, 2016.</i></p> <p>- <i>Jola Xhafo, E drejta penale ndërkombëtare, Tiranë, 2009.</i></p>
Literatura shtesë:	<p>- <i>William A.Schabas: International Criminal Court, Cambridge, 2001</i></p> <p>- <i>William A. Schabas, Gjenocidi në të drejtën penale ndërkombëtare, Prishtinë, 2003</i></p> <p>- <i>Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermeulen, E drejta Penale Evropiane, Tiranë, 2009.</i></p> <p>- <i>Enrico Amati, Matteo Casti, Emanuela Fronza, Paolo Lobba, Elena Maculan, Antonio Vallini,</i></p>



	<p><i>Interduzione al dritto penale international, tereza edizione, 2016. Torino.</i></p> <p><i>- Jean Pradel: Droit Penal General, Paris, 2000.</i></p> <p><i>- Dressler Joshua: Understanding criminal law, Cecond edition, 1995, New York. Tulkens, Francoise & Von de Kerchove : Introduction au droit penal, 1999, Bruksel.</i></p> <p><i>- Ligji për Bashkpunimin Juridik ndërkombëtar në çështiet penale, Ligji Nr.0/4L-2013, 31 korrik 2013.</i></p> <p><i>- Ligji nr. 05/l-053 për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar</i></p> <p><i>- Konventa për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, 1948.</i></p> <p><i>- Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi, 1993.</i></p> <p><i>- Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për Ruandën, 1994.</i></p> <p><i>- Statuti i Romës për Gjykatën e përhershme penale ndërkombëtare, 1998.</i></p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
Java e parë:	<p>Sugjerime të përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Prezantimi hyrës ✓ Njohja dhe qëllimi i lëndës ✓ Programi i lëndës ✓ Rezultatet e pritura ✓ Literatura ✓ Vlerësimi ✓ Politikat akademike <p>-Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e</p>	<p>Hyrje</p> <p>Prezantim për metodologjinë mbajtjes së ushtrimeve; Metodatat e vlerësimit në ushtrime</p>

	<p>zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën.</p> <p>-Hyrje në të drejtën penale ndërkombëtare</p> <p>-Përkufizimi i së drejtës penale ndërkombëtare; objekti dhe detyrat, funksioni, aktualiteti dhe perspektiva e së drejtës penale ndërkombëtare.</p>	
Java e dytë:	<p>-Zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare;</p> <p>-Fillet dhe zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare deri në luftën e Parë Botërore, pas luftës së Dytë Botërore;</p> <p>-Kontributi i OKB-së;</p> <p>-Kontributi i BE-së (Këshillit të Europian) në zhvillimin e kësaj të drejte;</p> <p>-Burimet e së drejtës penale ndërkombëtare;</p> <p>-Burimet ndërkombëtare;</p> <p>-Burimet interne të së DPN.</p>	<p>Lindja dhe zhvillimi Historik i DPN- së</p> <p>Shqyrtimi i burimeve të DPN- së</p>
Java e tretë:	<p>-Parimet themelore të së drejtës penale ndërkombëtare:</p> <p>-Parimi universal i aplikimit të së drejtës penale ndërkombëtare:</p> <p>-Parimi i ligjshmërisë;</p> <p>-Parimi <i>ne bis in idem</i>;</p> <p>-Parimi i përgjithshëm penal individual.</p>	<p>Trajtimi i parimeve themelore të DPN- së, me theks të shembujve konkret për secilin nga këto parime.</p>
Java e katërt:	<p>-Kontributi i së DPN në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e të drejtës penale (matriale);</p> <p>-Parimi i legalitetit;</p>	<p>Hulumtimi dhe prezentimet e studentëve për kontributin e të drejtave të njeriut në DPN</p> <p>Rastet e mbrojtjes së te drejtave te njeriut ne bazë te rregullave</p>

	<p>-Ndalesa e dënimeve të vrazhda dhe jo humane;</p> <p>-Abolimi i dënimeve me vdekje;</p> <p>-Dënimet alternative;</p> <p>-Mbrojtja dhe kompenzimi i viktimës, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë;</p> <p>-Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në të drejtën e procedurës penale.</p> <p>-Prezumpcioni i pafajësisë;</p> <p>-<i>Ne bis in idem</i>;</p> <p>-E drejta në gjykim të drejtë dhe në gjykatë të pavarur;</p> <p>-E drejta në gjykim brenda afatit të kuptueshëm;</p> <p>-E drejta për mbrojtje, ankesë, e drejta për mbrojtje ndërkombëtare;</p> <p>-Ndalimi i torturës dhe i formave të tjera të dhunës;</p> <p>-Roli i gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut me seli në Strasburg në këtë fushë;</p> <p>-Standartet lidhur me autorizimet dhe veprimet e policisë, prokurorisë, avokatisë;</p> <p>-Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në të drejtën penitenciare;</p> <p>-Aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e personave të burgosur dhe në paraburgim, ndalimi i veprimeve të vrazhda dhe jo humane ndaj personave me burgim, rregullat;</p> <p>-Rregullat europiane të burgjeve;</p> <p>-Rregullat, rekomandimet dhe rezultatet e ndryshme</p>	<p>europiane dhe standardeve europiane</p>
--	---	--

	për mbrojtjen e personave të dënuar.	
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> -Kufijtë e pushtetit represiv të shtetit; -Territori i shtetit; -Sipërfaqja tokësore, ujore, ajrore, anijet dhe fluturaket; -Selitë e oficiale të përfaqësuesve diplomatik; -Parimet e përcaktimit të pushtetit represiv të shtetit; -Teoritë lidhur me përcaktimin e vendit të kryrjës së veprave penale; -Tentativa dhe veprimet përgaditor; -Veprat penale permanente të përbëra të vazhduara dhe kolektive; -Veprat penale transite; -Veprat penale konekse. 	Shqyrtimi me shembuj nga shtrirja e legjislacionit të shtetit brenda territorit.
Java e gjashtë:	<ul style="list-style-type: none"> -Nocioni, karakteristikat themelore dhe format e ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare; -Format e ndihmës juridike-penalo ndërkombëtare në kuptimin e gjërë; -Ekstradimi; -Ndihma e "vogël" juridiko-penale ndërkombëtare -Cedimi i ndjekjes penale shtetit të huaj; -Ekzekutimi i aktgjykimit penal të gjykatës së shtetit të huaj; -Ndihma juridiko-penale ndërkombëtare e cila ushtrohet jashtë procedurës penale konkrete; 	Hulumtime dhe prezentime nga studentët për secilën formë e ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare.

	<ul style="list-style-type: none"> -Përzënia (deportimi) nga vendi; -Bashkëpunimi ndërkombëtar policer; -Shkëmbimi i informatave për personat e dënuar; -Mbikqyrja, ndihma juridike për të dënuarit dhe liruarit me kusht. 	
Java e shtatë:	Kolokiumi / Vlerësimi intermediar- Debate	
Java e tetë:	<ul style="list-style-type: none"> -Burimet juridike të ndihmës juridiko- penale ndërkombëtare në kuptimin e gjërë; -E drejta e brendshme si burim i ndihmës juridiko- penale ndërkombëtare; -Ekstradimi- nocioni dhe qëllimi i ekstradimit; -Obligimet e ekstradimit; -Konventat ndërkombëtare me të cilat është rregulluar ekstradimi; -Parimet themelore të ekstradimit; -Parimi i reciprocitetit, i ekstradibilitetit, i idenditetit të normave dhe parimi i specialitetit; -Pengesat juridike të ekstradimit; -Procedurat për ekstradimin e të pandehurve dhe të personave të dënuar; -Masat e ngjajshme me ekstradimin; -Ekstradimi i përkohshëm; -Dëbimi i të huajit nga shteti (deportimi) sipas Kodit Penal të Kosovës; -Rrëmbimi i personit nga shteti; 	<p>Shqyrtimi i ekstradimit Legjislacioni dhe marrëveshjet për ekstradim sipas legjislacionit të RKS.</p> <p>Punë me grupe me studentët për raste studimi, të ekstradimitit.</p>

	-Azili, nocioni dhe rëndësia e të drejtës së azilit.	
Java e nëntë:	-Ndhimja e "vogël" juridiko-penale ndërkombëtare; -Nocioni dhe historiku; -Parimet themelore të ndihmës së vogël juridike penale ndërkombëtare, pengesat juridike; -Veprimet e veçanta të ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare.	Shqyrtimi i parimeve dhe veprimeve themelore të ndihmës së "vogël" penale ndërkombëtare. Shembuj nga praktika e shteteve.
Java e dhjetë:	-Bashkëpunimi policor ndërkombëtar; -Organizatat ndërkombëtare të policies; -Interpoli; -Europoli; -Organizatat tjera ndërkombëtare policore; -Perspektivat e bashkëpunimit policer; Transferimi i procedurës penale shtetit të huaj; -Nocioni dhe arsyeshmëria e transferimit të procedurës penale; -Transferimi sipas legjislacionit penal të Kosovës; -Parimet themelore lidhur me transferimin e procedurës penale.	Hulumtim dhe prezentime nga studentët. Raporti I Kosovës me organizata për bashkëpunim policer ndërkombëtar.
Java e njëmbëdhjetë:	-Njohja e Aktgjykimeve penale të shtetit të huaj; -Nocioni dhe rëndësia e njohjes ndërkombëtare të aktgjykimit penal; -Kontributi i Kombeve të Bashkuara dhe i Këshillit të	Raste studimi dhe shembuj nga njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja.

	<p>Europës lidhur me njohjen e aktgjykimi të huaj penal; -Njohja e akgjykimit të huaj penal sipas të drejtës penale të Kosovës.</p>	
Java e dymbëdhjetë:	<p>-Ekzekutimi i Aktgjykimit të huaj penal; -Kuptueshmëria dhe burimet juridike; -Kushtet themelore të cilat duhet të përmbushen për ekzekutimin e aktgjykimit të huaj penal, dhe atë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës; -Procedurat e ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj.</p>	<p>Raste gjyqësore nga praktika e njohjes së aktgjyqiimeve të huaja në RKS.</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>-Gjykata penale ndërkombëtare (Nurbergut – Tokios, Hages, Ruandës dhe Hagës e përhershme); -Kompetencat e gjykatës penale ndërkombëtare; -Organizimi i gjykatës penale ndërkombëtare; -Organet e gjykatës penale ndërkombëtare; -Parimet e përgjithshme në të cilat mbështetet puna e gjykatës penale ndërkombëtare; -Themelimi i gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare (1998); -Gjykata Speciale për Kosovën; Gjykatat dhe Prokuroria Speciale për Kosovën, Fushëveprimi, roli, parimet, juridiksioni dhe rëndësia e saj.</p>	<p>Puna hulumtuese dhe prezentimi nga studentët të Statuteve të tribunaleve penale nd tribunaleve penale ndërkombëtare dhe dallimet mes tyre.</p> <p>Raste studimi nga praktika gjyqësore e tribunaleve penale ndërkombëtare.</p>



Java e katërbëdhjetë:	<p>-Veprat penale, përgjegjësia penale dhe sanksionet penale në të drejtën penale ndërkombëtare, nocioni;</p> <p>-Veprat penale ndërkombëtare sipas Kodit Penal të Kosovës;</p> <p>-Gjenocidi;</p> <p>-Krimet kundër njerzimit;</p> <p>-Krimet e luftës;</p> <p>-Përgjegjësia penale në të drejtën penale ndërkombëtare</p> <p>- Sanksionet penale në të drejtën penale nderkombëtare.</p>	Prezentimet e studentëve.
Java e pesëmbëdhjetë:	<p><i>-Debate rreth lëndës, diskutime, praktikim, këshilla dhe rekomandime, debate për përgaditjen e provimit përfundimtar.</i></p>	
Politikat akademike dhe kodi i sjelljës		
<p>- Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjerata dhe ushtrime, ku vijueshmëria do të evidentohet nëpërmjet listës së prezencës të studentëve në ligjërata dhe ushtrime.</p> <p>- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime, prezentimi i punimeve seminarike dhe aktivitete të tjera do të llogariten në notën përfundimtare.</p> <p>- Në ligjërata dhe ushtrime të trajtohen vetëm temat e parapara me këtë planprogram.</p> <p>- Komunikimi me studentët do të bëhet kryesisht përmes emailit dhe postimit të njoftimeve në objektet e Universitetit dhe personalisht gjatë konsultimeve.</p>		